



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUÇOVË

Nr _____ Prot

Datë ____ / ____ / 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT PARAPRAK TË FITUESIT

Për : “Z D R A V A” shpk

me adresë : Autostrada LushnjeFier km 4, Pasuria me nr 104/20 në zonën kadastrale 3268 9001

LUSHNJE

Procedura e prokurimit : Procedurë e Hapur – Punë ndërtimi.

Numri i referencës së procedurës : NR REF-15739-08-08-2024.

Përshkrim i shkurtër i kontratës, objekti : “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pavaforizuara”, me fond limit : 27 114 876 *(njëzetë e shtatë milion e njëqind e katërbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë)* lekë pa tvsh.

Afati për ekzekutimin e kontratës : 6 (gjashtë) muaj duke filluar nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët **X**

Njoftojmë se në procedurën e prokurimit kanë ofertuar 5 (pesë) operator ekonomik dhe konkretisht si më poshtë :

1. “Aida Construction” shpk me Nr Nipt-i M03116403L me ofertë ekonomike :
 - 21 462 630 *(njëzetë e një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë)* lekë pa tvsh.

2. “AVDULI” me Nr Nipit-i J66703306O shpk me ofertë ekonomike :
 - 23 036 200 *(njëzetë e tre milion e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind)* lekë pa tvsh.

3. “COLOMBO” me Nr NIPT-i J82916489E me ofertë ekonomike :
 - 23 154 790 *(njëzetë e tre milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë)* lekë pa tvsh.

4. “FLED” shpk me Nr Nipt-i K17621104C me ofertë ekonomike :
 - 23 897 600 *(njëzetë e tre milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind)* lekë pa tvsh.

5. “Z D R A V A” shpk me Nr Nipt-i J84003411K me ofertë ekonomike :
 - 26 703 780 *(njëzetë e gjashtë milion e shtatëqind e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë)* lekë pa tvsh.

* * *

Janë skualifikuar operatorët ekonomik ofertues si më poshtë :

1. “C O L O M B O” shpk me Nr Nipt-i J82916489E me arsytet si më poshtë :
 - Nuk plotëson pikën 2.3.3 të DST, pasi nuk ka deklaruar që disponon Ing. Topograf, si drejtues teknik në licensën e shoqërisë.
 - Nuk plotëson pikën 2.3.5 të DST, pasi nuk ka deklaruar që disponon punonjës të specializuar 2 karpentier.

- Nuk plotëson pikën 2.3.10 të DST, pasi nuk ka deklaruar që disponon mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës 2 kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton si dhe mjetin Dumper.

2. “AVDULI” shpk me Nr Nipt-i J66703306O me arsyet si më poshtë :

- Nuk plotëson pikën 2.3.11 të DST, pasi për realizimin me sukses të kontratës OE duhet të disponoj “Fabrikë për prodhimin e dyer dritare PVC në pronësi me pira/ose kontrate furnizimi. Për fabriken e prodhimit dyer dritare PVC dhe duraluminit operatorët ekonomik duhet të partaqesin kontratë blerje të makinerisë, çertifikatat e konformitetit ISO 9001:2015 mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent. Në rastin kur fabrika është me qëra ose me kontratë furnizimi, operatori duhet të disponoj të gjithë dokumentacionin e mësipërm si dhe dokumentacionin që vërteton lidhjen e shoqërisë prodhuese me distributorin. Nga ana e OE nuk është dorëzuar dokumentacioni provues për disponimin e një fabrike prodhim dyer dritare PVC.

3. “AIDA CONSTRUCTION” shpk me numër Nipt-i M03116403L me arsyet si më poshtë :

- Në proces verbalin e datës 04.09.2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shpallur fitues subjektin “AIDA Construction” shpk me Nr Nipt-i M03116403L me ofertë ekonomike 21 462 630 (njëzetë e një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh, duke e ftuar të paraqesë pranë autoritetit kontraktor dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Në datën 09.09.2024 ky subjekt ka paraqitur pranë AK sipas shkresës Nr 3024 Prot dokumentacionin e kërkuar. Pas verifikimit nga ana e KVO-së të dokumentacionit fizik, OE rezulton me mangësi si më poshtë :

Ka gabime aritmetike në hartimin e preventivit. Konkretisht vlera e ofruar nga OE sipas Shtojcës 1 (formularit të ofertës), është 21 462 630 lekë pa tvsh, ndërsa shumatorja e të gjitha zërave të ofruar në preventiv është 21 997 460 lekë pa tvsh. Diferenca midis këtyre dy vlerave është 534 830 lekë pa tvsh ose e përkthyer në përqindje 2.49 %. Në këto kushte referuar VKM-së Nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 82 pika 3 parashikon se ;

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi.
- Nuk arrin të plotësojë pikën 2a të DST-së dhe konkretisht :
 - Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e ti sipas QKB-së.

Nga verifikimi që kreu Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në QKB-në e ofertuesit, rezulton se në datën 19.01.2024 është hapur adresa dytësore "Vlore; Himare; ; HIMARE; Rruga Kryesore Qender,Pasuria Nr.2/1,ZK.2030; dhe është hequr në datën 18.06.2024.

Për sa më sipër, ofertuesi ka dështuar të paraqesë vërtetimin për pagesën lokale për adresën e lartpërmendur.

4. “Fled” shpk me Nr NIPT-i K17621104C me arsyet si më poshtë :

Në proces verbalin e datës 17.09.2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shpallur fitues subjektin “Fled” shpk me Nr Nipt-i K17621104C me ofertë ekonomike 23 897 600 (*njëzetë e tre milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind*) lekë pa tvsh, duke e ftuar të paraqesë pranë autoritetit kontraktor dokumentat provuese për vetëdeklarimet në fomularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

Në datën 20.09.2024 ky subjekt ka paraqitur pranë AK sipas shkresës Nr 3164 Prot dokumentacionin e kërkuar.

Pas verifikimit nga ana e KVO-së të dokumentacionit fizik, OE rezulton me mangësi si më poshtë :

- Nuk plotëson pikën 2.3.11 të DST, pasi për realizimin me sukses të kontratës OE duhet të disponoj “Fabrike për prodhimin e dyer dritare PVC në pronësi me pira/ose kontrate furnizimi. Për fabriken e prodhimit dyer dritare PVC dhe duraluminin operatorët ekonomik duhet të partaqesin kontratë blerje të makinerisë, çertifikatat e konformitetit ISO 9001:2015 mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent.

Në rastin kur fabrika është me qëra ose me kontratë furnizimi , operatori duhet te disponoj të gjithë dokumentacionin e mësipërm si dhe dokumentacionin që vërteton lidhjen e shoqërisë prodhuese me distributorin.

Nga ana e OE është dorëzuar kontrata e furnizimit por për fabrikën fabriken e prodhimit dyer dritare PVC dhe duraluminit nuk janë paraqitur kontrata e blerjes së makinerisë si dhe çertifikata e konformitetit ISO 9001:2015 mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent.

- Nuk arrin të plotësojë pikën 2.3.10 të DST-së dhe konkretisht :
Për mjetin autobot uji mungon çertifikata e transportit si dhe taksat vjetore e cila ka skaduar.
Mungon dokumentacioni provues për disponimin e një mjeti dumpar dhe një vinç kulle me krah jo më pak se 5 m.
- Nuk plotëson pikën 2.3.5 të DST-së dhe konkretisht :
Për punonjësën E.S të deklaruar si punonjës/specialist duralumini mungon dëshmia e kualifikimit teknik.

* * *

Renditja është si më poshtë :

1. “Z D R A V A” shpk me Nr Nipt-i J84003411K me ofertë 26 703 780 *(njëzetë e gjashtë milion e shtatëqind e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë)* lekë pa tvsh.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Z D R A V A” shpk se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 26 703 780 *(njëzetë e gjashtë milion e shtatëqind e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë)* lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11 / 10 / 2024.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Kreshnik HAJDARI